

Mësoj  
rreth  
fëmijës

# Fëmijë invalid

## E çfarë pastaj?

Lindja e një fëmije invalid mund të shkaktojë panik tek prindërit dhe familjarët e tij. Paniku, i shoqëruar nga mungesa e informimit të drejtë, mund të çojë familjen drejt situatave të vështira ekonomike dhe psikologjiko-shpirtërore.

Gjithsesi nuk duhet të ketë panik. Edhe prindër të tjerë përballen me të njëjtën gjendje. Duke folur me prindër të tjerë, mundeni, nga njëra anë, të informoheni si të veproni më mirë dhe, nga ana tjetër, të ndani ndjenjat tuaja me ta. Është e rëndësishme të jeni të informuar lidhur me zhvillimet e shkencës rreth gjendjes së fëmijës suaj.

Besoni tek fëmija juaj. Të gjithë njerëzit janë të veçantë. Krijoni ambient të përshtatshëm për zhvillimin sa më të mirë të tij. Sidoqë të jetë, mos humbisni kohë dhe pranoni sa më parë gjendjen e tij.

### Fëmijë me lëvizje të kufizuar

Lëvizje të kufizuar kanë personat me pjesë trupore të dobëta apo të paralizuar, me gjymtyrë të palëvizshme, me mungesë relative të pjesëve apo të të gjitha pjesëve të trupit, të gjymtuarit e përkohshëm etj. Këta persona lëvizin me ritme më të ngadalta dhe mundet që për të lëvizur përdorin disa mjete ndihmëse, si: bastunë, karrige me rrota, paterica etj.

Problemet e mësipërme mund t'i kenë nga lindja ose të fituara më pas, d.m.th. të shkaktuara nga aksidente gjatë jetës së personit.

Me lëvizje të kufizuar mund të përfundojnë edhe rastet me paralizë celebrale, d.m.th. raste të dëmtimit anatomik të përhershëm e të paevolueshëm të pikave kryesisht lëvizëse të trurit apo raste të sëmundjeve të tjera.


Në vartësi me cilat pjesë të trupit janë gjymtuar, vëmë re:

- Tetraplegji, kur janë paralizuar gjymtyrët e sipërme dhe të poshtme.
- Hemiplegji, kur janë paralizuar gjymtyrë të bashkërenditura (të njëres anë të trupit), një poshtë dhe një lart.
- Paraplegji, kur janë paralizuar vetëm dy gjymtyrët e poshtme.

Zakonisht, pengesën kryesore të fëmijëve me lëvizje të kufizuar për të ndjekur arsimin, e përbën mungesa e shteghyrjes së posaçme në godinat shkollore dhe në strukturat e ndryshme edukative (si: kompjutera etj.). Nëse e favorizon ambienti arsimor, fëmija mund të marrë pjesë i pamvarur në të gjitha aktivitetet e shkollës. Në disa raste mund të kërkohet paralelisht mbështetje nga persona ndihmues dhe specialistë.

**Ente ku mund të drejtoheni:**

Konfederata Kombëtare e Personave Invalidë  
V. Olgas 114  
K.P. 54643  
Selanik  
2310 842742  
[www.esamea.gr](http://www.esamea.gr)



## Fëmijë me shikim të kufizuar

Me termin «Persona me shikim të kufizuar» përkruhen të gjithë personat me humbje të plotë apo të pjesëshme të shikimit. Humbja e shikimit nuk lidhet tashmë vetëm me moshat e mëdha. Ekzistojnë probleme të ndryshme shikimi. Disa persona kanë verbim të përgjithshëm, ndërsa disa të tjerë mund të kenë fushë të kufizuar shikimi, mprehtësi të kufizuar shikimi ose ndonjë sindromë tjetër gjinore që ka të bëjë me shikimin.

Ekzistojnë diferencime të rëndësishme midis një personi të lindur i verbër dhe një tjetri që verbimi i shkaktohet nga ndonjë aksident apo sëmundje gjatë jetës së tij. Gjithashtu, ndodh kur një person vuan nga një sëmundje degjeneruese, si rezultat i saj, shikimi i tij humbet gradualisht.

Tregues të ndryshëm mund të deklarojnë ekzistencën e një problemi në shikim, si: sy të kuq, lëvizje e vazhdueshme e syve, mungesa e reagimit nga ngacmimet në shikim, aksidente nga të ashtuquajturat paaftësi, frikë nga drita, etj. Në çdo rast këshillohen vizita të vazhdueshme në pediokulist, sidomos kur fëmija është në moshën një vjeç, katër vjeç dhe para hyrjes në fillore.

Për individët me shikim të kufizuar, lëvizja dhe orientimi në ambiente të ndryshëm arrihet pas një pune të lodhshme. Jo të gjithë personat që kanë probleme shikimi nevojiten domosdoshmërisht ndihmë në mënyrë që të kryejnë veprimet e përditshme. Gjithësesi, qëllimi është që fëmija me probleme shikimi, si dhe çdo fëmijë tjetër, të jetë i pamvarur dhe të lëvizë gjithmonë me siguri.

Theksohet se fëmijët me probleme në shikim mund të fitojnë më vonë edhe probleme në lëvizje për arsye të shikimit të kufizuar. Zakonisht fëmijët me shikim të kufizuar ndjekin rregullisht programin mësimor të shkollave të përgjithshme, me mbështetje specifike paralelisht. Në Shkollën e të Verbërve mësojnë shkrimin Braille dhe kompjuterat elektronik. Gjithashtu Lidhja Mbarëhelenike e të Verbërve, e cila përmban shërbime sociale, ofron mësim falas të lëvizjes, të orientimit dhe të aftësive të tjera të dobishme për jetën e përditshme.



### Ente ku mund të drejtoheni:

Lidhja Mbarëhelenike e të Verbërve  
Unioni Periferik i Makedonisë Qendrore  
V. Olgas 114  
K.P. 54643  
Selanik  
Tel. 2310 250677  
e-mail: pst8pekm@otenet.gr

### «Amymoni»

Shoqata e Prindërve, Kujdestarëve dhe Miqve të Personave me Shikim si dhe me Aftësi të Kufizuara.  
Kon. Saraçi 10, Kalamaria, 55132  
Selanik  
Tel. 2310 450440, 2310 905781  
[www.amymoni-thes.gr](http://www.amymoni-thes.gr)

## Fëmijë me dëgjim të kufizuar

Termi «person me dëgjim të kufizuar» përkufizon individë me nevoja dhe aftësi të ndryshme komunikimi.

Njerëzit me shurdhim të pjesshëm mund të ndodhen në këtë gjendje që nga lindja ose u shkaktohet pas ndonjë faze konkrete të jetës së tyre.

Një dallim që bazohet në rezultatin e humbjes së dëgjimit quan shurdh atë që nuk kupton të folurën me dëgjimin e tij dhe komunikon kryesisht me gjuhën e shenjave. Veshrëndë është ai që mban kufje ose jo, që vështirësohet të kuptojë të folurën vetëm me dëgjimin e tij dhe zakonisht ka të folur dalluese.

Numri i njerëzve me dëgjim të kufizuar është i madh dhe heterogjen, nëse përfshijmë në të edhe ata që humbasin dëgjimin e tyre në moshë të madhe si dhe fëmijët që në moshë të vogël paraqesin shpesh probleme dëgjimi.

Sjellje konkrete të fëmijës mund të shkaktohen nga dëgjimi i kufizuar i tij/saj. Vini re nëse nuk reagon nga ngacmime dëgjimi (p.sh. zhurma të forta etj.), apo ndoshta reagimet e tij ndryshojnë përkatësisht me drejtimin nga ku vjen tingulli. (Mundet që fëmija të ketë dëgjim të kufizuar vetëm nga njëri vesh i tij/saj). Gjithashtu, mungesa e reagimit ndaj zhurmave shumë të forta kur fëmija fle, mund të jetë një tregues i ndonjë problemi në dëgjimin e tij/saj.

Në thelb, ambienti shkollor i fëmijës ndryshon vetëm në rast se ai/ajo është tërësisht i/e shurdhët. Atëherë ai/ajo ndjek Shkollën e Shurdhëve ku mësimet bëhen në gjuhën e shenjave. Në çdo rast tjetër fëmijët ndjekin shkollën e përgjithshme.

Nëse një fëmijë ka ndonjë problem dëgjimi nuk do të thotë se është tërësisht i shurdhët. Për këtë është e nevojshme të siguroheni me analiza për shkallën ekzakte të dëgjimit të tij/saj. Ndoshta mund të përdoren kufje që ndihmojnë dëgjimin e fëmijës. Gjithësesi, drejtohuni pediatrit tuaj. Vlen të nënvizohet se problemet e dëgjimit mund të çojnë edhe në probleme të të folurit, përderisa fëmija, në thelb, zhvillon të folurën e tij/saj nëpërmjet ngacmimeve tingullore.

### Ente ku mund të drejtoheni:

#### Federata e Shurdhëve të Greqisë

El. Venizelu 236  
K.P. 163 41 Iliupoli  
Athinë  
Tel. 210 5233950  
Fax 210 5233968]  
Cel 6942019348  
Email info@omke.gr  
<http://www.omke.gr/>

CODA quhet organizata e familjeve që ndërsa prindërit janë të shurdhër, fëmijët dëgjojnë. Kjo organizatë krijon kushte të përshtatshme për zhvillimin më të mirë të tyre.

Për Greqinë e Veriut mund të drejtoheni në:

Bashkimi i Shurdhëve të Greqisë së Veriut  
Leoforos Klallitheas 3, Abelokipi,  
Selanik  
Tel. 2310 730332  
[www.ekbe.gr](http://www.ekbe.gr)




## Çfarë parashikon ligji (grek) për integrimin e fëmijëve invalidë në arsimin publik?

Ligji kryesor është ai me nr. 3699, GZ 199-A-2 tetor. 2008 “Edukimi dhe Arsimitimi Specifik i Personave Invalidë ose me Nevoja Specifike Arsimore”.

Në të parashikohet se shteti ka për detyrë të ofrojë arsim publik dhe falas për personat invalidë.

Përsa i përket infrastrukturave, parashikohet që fëmijët invalidë do të kenë shteghyrje të posaçme në godinat dhe në programet arsimore të Njërive Shkollore të Edukimit dhe të Arsimit Specifik (të ashtuquajturat shkolla “speciale”).

Në shkollat konvencionale përgjegjës për përcaktimin e arsimtarëve apo të aktorëve të tjerë që ndihmojnë fëmijët invalidë është KEDDY - Qendra e Diaforodiagnozës (diagnozë diferenciale), Diagnozës dhe Mbështetjes. Ata vlerësojnë ndryshimet që duhet të bëhen duke dhënë propozimet e tyre nëpër shkolla. Gjithësesi, mirë është të komunikoni me mësuesin e fëmijës suaj që t’ju shpjegojë procedurat.



*Autore teksti*

**Panajotis Çalis** - Inxhinier Mekanik (specialist në çështjet e qarkullimit të personave invalidë)

**Paskalina Kalle** - Mësuese e Lëvizjes së të Verbërve

**Spiros Kutelis** - Përkthyes i gjuhës së shenjave

*Enti zbatues*

**POLIDHROMOS: Grupi dhe Botimi periodik për Dytëgjuhësinë dhe Shumëkulturën në Arsim dhe në Shoqëri**

Koordinatorë të programit

**Birbili Maria – Cokalidhu Rula**

Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe të Arsimit Parashkollor, Universiteti Aristoteli Selanik

**Website:** [www.polydromo.gr/dialogos](http://www.polydromo.gr/dialogos)

*Përkthyes*

**Valbona Hystuna**

*Përpunuan tekstin*

**Evi Marku**



[www.polydromo.gr](http://www.polydromo.gr)  
[polydromo@polydromo.gr](mailto:polydromo@polydromo.gr)

**Me mbështetjen e**

 **STAVROS NIARCHOS FOUNDATION**